



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
Drejtoria e Buxhetit dhe Financës

RELACION

MBI REALIZIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT FAKTIK PËR 4 MUJORIN E I-rë TË VITIT 2019, TË BASHKISË LEZHË

Të nderuar këshilltarë !

Ju paraqesim realizimin e zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e I-rë të vitit 2019, konkretisht si më poshtë;

❖ **Realizimi i të ardhurave vendore ;**

Të ardhurat gjithsej janë realizuar në masën 148.⁷ % ose 91,479.⁵ mijë lekë më shumë se plani dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018 të ardhurat janë realizuar 4.² herë , ose në vlerë absolute janë realizuar 212,291.⁴ mijë lekë më shumë.

Për periudhën 4 mujore realizimi i të ardhurave sipas strukturës ekonomike paraqiten si më poshtë;

- Të ardhurat nga taksat vendore janë realizuar 150.⁵ % ose 75,818.⁹ mijë lekë më shumë se plani;
- Të ardhurat nga taksat e ndara janë realizuar 85 % ose 1,636 mijë lekë më pak se plani;
- Të ardhurat jotatimore janë realizuar 164.⁸ % ose 17,296.⁶ mijë lekë më shumë se plani.

Me mosrealizime paraqiten;

1.Të ardhurat nga taksa mbi pasurinë, e cila ka krijuar një defiçit prej 1,287.⁷ mijë lekë në raport me planin e të ardhurave, ku kanë krijuar mosrealizim të ardhurat nga taksa mbi ndërtesat për 5.⁸ %, ose në vlerë mosrealizimi është 1,113.1 mijë lekë dhe taksa mbi token bujqësore për 82 % ose në vlerë mosrealizimi është 6,561.⁵ mijë lekë.

2.Të ardhurat nga taksa e kalimit të të drejtës së pronësisë, e cila ka krijuar një defiçit prej 1,093.⁹ mijë lekë, në raport me planin e të ardhurave, të ardhura të cilat janë realizuar 64.⁶ %.

3.Të ardhurat nga taksa e biznesit të vogël, e cila ka krijuar defiçit prej 1,458.² mijë lekë në raport me planin, taksë e cila është realizuar 62.⁸ %.

4.Të ardhurat nga tarifa e zënies hapësirave publike është realizuar 6.³ %, duke sjellë një mosrealizim prej 1,873.² mijë lekë më pak se plani.

5.Të ardhurat e tjera nga institucionet varësisë janë realizuar 51.⁸ % ose 3,332.⁴ mijë lekë më pak se plani.

6. Të ardhurat nga tarifat për kulturën janë realizuar 45.⁴ % ose 153 mijë lekë më pak se plani.

7.Paraqiten me realizime ose tejkalime të gjitha të ardhurat nga taksa dhe tarifat e tjera.

Duke analizuar ecurinë e realizimit të të ardhurave për periudhën, parashikohet një situatë e mirë dhe e favorshme në përmbushjen e detyrimeve sipas programeve buxhetore dhe strukturës ekonomike për vitin 2019. Për periudhën në vazhdim, kërkohet më shumë vëmendje në drejtim të grumbullimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore që paraqiten me mosrealizime, si dhe vjeljen e detyrimeve të prapambetura që kanë të tretët ndaj bashkisë.

❖ Realizimi i shpenzimeve buxhetore ;

Realizimi i shpenzimeve gjithsej për 4 mujorin e parë të 2019 është 90.⁴ % ose me një mosrealizim prej 60,000 mijë lekë më pak se plani, dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018 shpenzimet gjithsej janë realizuar 116 % ose 77,707 mijë lekë më shumë.

Realizimi i shpenzimeve sipas burimeve të financimit paraqitet si më poshtë:

- Me fondet e bashkisë ku përfshihen (granti i pakushtëzua, të ardhurat vendore dhe transfertat specifike) realizimi i tyre është në masën 91.⁴ %, me një mosrealizim në vlerë prej 37,134 mijë lekë më pak se plani;

- Shpenzimet që mbulohen me fondet e buxhetit të shtetit (transferta e kushtëzuar dhe FZHR) janë realizuar në masën 89.⁷ % ose paraqiten me një mosrealizim në vlerë prej 22,866 mijë lekë më pak se plani.

Shpenzimet sipas strukturës së programeve dhe funksioneve paraqiten si më poshtë:

1-Shpenzimet për planifikim, menaxhim, administrim janë realizuar 63 % ose 19,434.⁹ mijë lekë më pak se plani.

2-Shpenzimet për çështje financiare dhe fiskale janë realizuar 91.⁸ % ose 7,272.⁹ mijë lekë më pak se plani.

3-Shpenzimet për gjendjen civile janë realizuar 92.² % ose 229.¹ mijë lekë më pak se plani.

4-Shpenzimet për QKB janë realizuar 92.⁵ % ose 44.⁶ mijë lekë më pak se plani.

5-Shpenzimet për arsimin parashkollor janë realizuar 90.⁵ % ose 7,781 mijë lekë më pak se plani.

6-Shpenzimet për arsimin parauniversitar janë realizuar 93.⁹ % ose 928.³ mijë lekë më pak se plani.

7-Shpenzimet për konviktin janë realizuar 85.² % ose 687 mijë lekë më pak se plani.

8-Shpenzimet për infrastrukturën rrugore janë realizuar 98.¹ % ose 833.⁷ mijë lekë më pak se plani.

9-Shpenzimet për shërbimin policor (policia bashkiake janë realizuar 97.⁵ % ose 181.⁴ mijë lekë më pak se plani.

10-Shpenzimet për administrimin e pyjeve janë realizuar 85.¹ % ose 1,170.⁶ mijë lekë më pak se plani.

11-Shpenzimet për mbrojtjen civile dhe zjarri janë realizuar 90.¹ % ose 1,264.¹ mijë lekë më pak se plani.

12-Shpenzimet për shërbimet sociale (PAK) janë realizuar 87.⁸ %, ose 22,357.⁹ mijë lekë më pak se plani

13-Shpenzimet për ujitjen dhe kullimin janë realizuar 87.⁷ % ose 1,343.⁸ mijë lekë më pak se plani.

14-Shpenzimet për strehimin social janë realizuar 96.² % ose 75.⁶ mijë lekë më pak se plani.

15-Shpenzimet për menaxhimin e mbetjeve urbane janë realizuar 86.⁸ % ose 6,569.⁸ mijë lekë më pak se plani.

16- Shpenzimet për familjet dhe fëmijët (ndihma ekonomike dhe çerdhe) janë realizuar 93 % ose 1,917.⁵ mijë lekë më pak se plani.

- 17-Shpenzimet për edukimin dhe sportin janë realizuar 87.¹ % ose 1,111.⁹ mijë lekë më pak se plani.
- 18-Shpenzimet për planifikimin urban janë realizuar 93.⁶ % ose 716 mijë lekë më pak se plani.
- 19.Shpenzimet për trashëgimin kulturore janë realizuar 65.¹ % ose 3,840.⁶ mijë lekë më pak se plani.
- 20.Shpenzimet për ndriçimin publik janë realizuar 80.² % ose 540 mijë lekë më pak se plani.
- 21.Shpenzimet për KUZB janë realizuar 99.⁹ % ose 0.⁷ mijë lekë më pak se plani.
- 22.Shpenzimet për emërgjencat civile janë realizuar 95.⁸ % ose 337.⁴ mijë lekë më pak se plani.
- 23.Shpenzimet për turizmin janë realizuar 83.² % ose 413.⁴ mijë lekë më pak se plani.
- 24.Shpenzimet për shërbimet publike janë realizuar 98.⁹ % ose 131.² mijë lekë më pak se plani.
- 25.Shpenzimet për shërbimin bujqësor dhe sigurinë ushqimore janë realizuar 98.⁷ % ose 81.² mijë lekë më pak se plani.
- 26.Shpenzimet për të moshuarit janë realizuar 99.⁶ % ose 1.¹ mijë lekë më pak se plani.
- 27.Shpenzimet për huamarrjen janë realizuar 100 %.

Për menaxhimin më të mirë të situatës në të ardhmen si në drejtim të realizimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve mendoj që të përmirësojmë punën në drejtim të;

- Grumbullimit të të ardhurave nga taksa mbi pasurinë, e në vecanti e taksës mbi ndërtesave, dhe taksës mbi tokën bujqësore; të ardhurat nga tarifa e pastrimit, tarifa e hapësirës publike, të ardhurat nga qerat mbi ndërtesat, si dhe të ardhurat e tjera, për të mundësuar realizimin e tyre për vitin 2019.
- Përdorimit më me efektivitet të shpenzimeve, duke u përqëndruar kryesisht në kryerjen e atyre shpenzimeve më të domosdoshme dhe të nevojshme.
- Rritjes së performancës së punës për të mundësuar realizimin e investimeve të parashikuara, dhe uljen e shpenzimeve administrative.
- Një vëmendje gjatë kësaj periudhe është treguar edhe për amortizimin e detyrimeve kreditore të krijuara ndër vite, ku janë likujduar të gjitha detyrimet e vitit 2018, dhe të vazhdohet më tej për uljen e tyre në të ardhmen.
- Nga drejtuesi e EMP-it duhet të monitorohet dhe të raportohet për realizimin e zbatimit të buxhetit për periudhën 4 e 8 mujore dhësi vjetor (për të gjithë treguesit financiar dhe indikatorët e performancës), sipas programeve përkatëse që drejtojnë

Ky ishte një relacion mbi realizimin e zbatimit të buxhetit për 4 mujorin e I-rë të vitit 2019.

Bashkëlidhur, evidenca e realizimit të të ardhurave vendore dhe shpenzimeve sipas programeve.

DREJTORESHA E BUXHETIT DHE FINANCËS

Anilda MEMAJ